



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-29282 2026

Datë: 05.08 2026

Në bazë të nenit 12, nenit 17 shkronja (b) dhe nenit 40 paragrafi (1) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28, qershor 2008), nenit 5 nënparagrafi 1.2, si dhe neneve 10, 11, 16 dhe 26 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 ("Gazeta Zyrtare", nr. 30, datë 23.08.2013), si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, si dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Klinës, nr. 01-110-1232/10, datë 07.04.2010 sipas shkresës së MMPH-DL-3149-2/26- datë 26.06.2026 për rishqyrtimin e vendimit 01Nr.06-15184/2026, Kuvendi i Komunës së Klinës, në mbledhjen e VII-të të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 31.07.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Rishqyrtim i vendimit

Rishqyrtohet vendimi 01Nr.06-15184/2026 për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës sipas shkresës së MMPH- DL-3149-2/26- të datës 26.06.2026 duke ndryshuar-plotësuar nenin 5 të vendimit.

Neni 2

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet vendimi për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Klinës për periudhën 8 vjeçare 2026-2034.

Neni 3

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Harta zonale e komunës, është një dokument shumë sektorial, që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e komunës, për periudhën tetë (8) vjeçare.

Neni 4

Qëllimi i hartimit

Me Hartën zonale të Komunës, nga neni 2 i këtij vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale, në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në komunën e Klinës, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe rurale.

Neni 5

Kufiri i territorit

Territori i Komunës së Klinës ndahet në 43 zona kadastrale, me një sipërfaqe të përgjithshme prej ($S=30,905.26ha$), = **309052611m²** sipas listës përkatëse të njësive kadastrale.

Klinë	KADASTRA
08	Berkovë
08	Binqë
08	Bokshiq
08	Budisalc
08	Çabiç
08	Caravik
08	Çeshkovë
08	Çupevë
08	Deis
08	Dobrovodë
08	Dobërdol
08	Dollc
08	Dollovë
08	Petriq i Ultë
08	Drenoc
08	Dranashiq
08	Dresnik
08	Dugajevë
08	Dush
08	Dusheviq
08	Petriq i Epërm
08	Grabanicë
08	Grebniq
08	Gllarevë
08	Jagodë
08	Jashanicë
08	Klinë
08	Klinafc
08	Kpuz
08	Nagllavë

08	Prçevë
08	Rudicë
08	Siqevë
08	Stupë
08	Shtupel
08	Sverkë
08	Krushevë
08	Gjurgjevik
08	Videjë
08	Volljak
08	Zabërgjë
08	Zajm
08	Zllakuqan

Neni 6

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 7

Mjetet dhe mekanizmat për hartim

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës, si dhe me angazhimin e konsulentëve të jashtëm individual të cilët i ka kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik sipas ligjit.

Neni 8

Afati i hartimit

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor sipas nenit 2 të këtij vendimi është e obliguar që Hartën Zonale të Komunës ta hartojë në afat prej dymbëdhjetë (12) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 9

Konsultimet publike

Projekti i hartës zonale të Komunës, para finalizimit do të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e HZK në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 10
Afati i vlefshmërisë

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare.

Neni 11
Gjuha zyrtare

Dokumenti hartohet në gjuhët zyrtare të komunës dhe dorëzohet në së paku 3 (tre) kopje fizike të vulosura dhe 3 (tre) kopje digjitale.

Neni 12
Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraprarë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174.

Neni 13

Harta Zonale duhet të harmonizohet me Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi, bazuar në Ligjin Nr. 08/L-284, si dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- ***MAPL;***
- ***Kryetari i Komunës;***
- ***Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;***
- ***Zyra për Informim;***
- ***Arkivi***

